REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/02 22789
Dt.04.01.2018

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Drejtoria për Arsim e Komunës së Gjakovës,** për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë – Shkollës Fillore dhe Mesme e Ulët në fshatin Korenicë, Komuna Gjakovë me etazhitet **P+0**, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: Aplikuesit: Drejtoria për Arsim e Komunës së Gjakovës, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë – Shkollës Fillore dhe Mesme e Ulët në fshatin Korenicë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Kushteve ndërtimore për rregullimin e hapësirës me numër: 07-351/02-10947 dt. 18.05.2017 në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 399-1 dhe 97-2 , ZK: Korenicë, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës" Gjakovë dhe ngastrës nr. 398-0 ZK Korenicë P.SH. Rrugët publike, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit të cekur si më lartë, etazhiteti i objektit është P+0.

II. Hartimin e projektit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë me destinim Shkollë Fillore dhe e Mesme e Ulët nga pika 1. e këtij Aktvendimi e ka bërë Studio projektuese URBAN+ nga Prishtina.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik i cili është punuar bazuar në dokumentacionin e prezantuar, i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtrojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Drejtoria për Arsim e Komunës së Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/02- 22789, të datës 03.112017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë - Shkollës Fillore dhe Mesme e Ulët në fshatin Korenicë, Komuna Gjakovë, me etazhitet **P+0**, në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 399-1, 398-0 dhe 97-2 , ZK: Korenicë, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës" Gjakovë siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 , të datës 15.05.2017, i vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 10.11.2017, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës - Gjakovë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndëve : ZYR/DA dt.10.11.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet ndërtimore me nr. 07-351/02-10947 dt.18.05.2017 të lëshuara nga DUMM,
5. Raportin mbi punimet gjeomekanike hulumtuese dhe kërkimet laboratorike ne lokacionin e parashikuar per ndërtimin e shkollës në fshatin Korenicë, i hartuar nga kompania 'GEOtest Engineering" Rahovec
6. Leja Mjedisore Komunale nr.07/351/02-22787 dt.04.01.2018
7. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01- 22786, dt.09.11.2017, nga Inspektorjati Sanitar Komunal- Drejtoria e për Punë Inspektuese e Komunës së Gjakovës.
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.16/17, me datë 13.11.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent pranë MPB Prishtinë.
9. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1024 dt. 05.06.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, nr. 1588 të datës 23.05.2017.
11. Pëlqimin nga PTK –Vala, me nr. 27, dt.23.05.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga Studio Projektuese " URBAN +" Prishtinë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nën paragrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.-6.2015.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:
- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Arsim**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arhives.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani. jur. I dipl.

Drejtori

Arben Bakalli, jurist


Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Prone

KOPJE PLANI

Zona kad. KORENICË"
Posedues: P. SH. KUVENDI KOMUNËS - GJAKOVË

Shk. zvog. 1: 500

Veriu



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m²	
97-2			KULLOSE	3	0	55	50	
			NDËRTESË	—	0	04	45	
399-1			KULLOSE	4	0	16	72	
Gjithësejtë					00	76	67	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:


Gjakovë d. 10.11.2017

K.K. GJAKOVË
Z.K. : Korenicë
Ng. nr. 97-0

PLAN SITUACIONI P=1:1000

KOORDINATAT PER PIKETIM TE OBJEKTIT

X=7447809.6277 Y=4693101.0469
X=7447847.5422 Y=4693093.4150
X=7447844.7005 Y=4693079.2981
X=7447822.8014 Y=4693083.6889
X=7447821.5714 Y=4693077.5785
X=7447821.0910 Y=4693077.6752
X=7447816.6461 Y=4693055.5931
X=7447813.7050 Y=4693056.1851
X=7447812.8910 Y=4693052.1413
X=7447800.2937 Y=4693054.6770
X=7447809.6277 Y=4693101.0469



Gjakovë,
16.05.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrolloi: Durrije Berisha I.D.A.

15.05
GPS
Auto CAD 2004